

● BREAKING NEWS

PËRPLASJA PËR INCENERATORËT, RAMA NXJERR ‘BLOF’ ME DOKUMENTE LULZIM BASHËN: GË

AKTUALITET

Përleshje mes të rinjve në një lokal në Elbasan, plagosen me armë zjarri tre persona

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
8 PRILL 2017



Tre persona mbetën të plagosur mesditën e djeshme në një lokal në dalje të Elbasanit, pas një konflikti banal. Burime zyrtare policore njoftuan ditën e djeshme se, ngjarja ndodhi kur dy vëllezërit, Franc e Hajdar Copa u konfliktuan me dy persona të tjerë, Julian e Klevis Gjini. Ata u përfshinë fillimisht në një sherr me sende të forta e grushte, ndërsa më pas konflikti degjeneroi në përdorimin e armëve të zjarrit. Nga të shtënat mbetën të plagosur dy kushërinjtë, Armando e Klevis Gjini, si dhe Hajdar Copja. Pas marrjes së këtij informacioni, forca të shumta policore mbërritën në vendin e ngjarjes duke sekuestruar 13 gëzhoja të kalibrave 7.65 mm dhe 9 mm, që i përkasin dy armëve të ndryshme. Janë të njëjtat burime që konfirmojnë se, shkak për sherrin, dyshohet të jetë bërë një konflikt i vjetër mes të rinjve kur kanë qenë rezidentë në Angli. Klevis Gjini, dyshohet se mund të jetë përfshirë në trafik droge në Britani. Njëri prej të plagosurve ka marrë plumb në krah, tjetri në këmbë, ndërsa personi i tretë është plagosur me mjete të forta. Në lidhje me këtë rast hetuesit po verifikojnë edhe pista ta të tjera të mundshme të ngjarjes. Nga ana tjetër policia ka shoqëruar të afërm të palëve, apo dëshmitarë që mund të kenë dijeni mbi rrethanat e kësaj ngjarjeje. Sakaq materialet e mbledhura iu kaluan prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për veprime të mëtejshme. Të shtënat me armë shkaktuan panik për disa minuta në këtë aks, ndërsa në hyrjet e daljet e Elbasanit policia ngriti postblloqe duke ushtruar kontrolle.

Reagimi i policisë

Policia e Elbasanit mori njoftim se në një lokal në fshatin Bradashesh ka pasur konflikt dhe të shtëna me armë zjarri ndërmjet disa personave. Menjëherë janë organizuar shërbimet dhe kanë mbërritur në vendngjarje, si dhe u ngritën pikat e kontrollit për ndalimin e autorëve të dyshuar. Policia ka konstatuar se në konflikt ishin përfshirë 4- 5 persona, ndërsa ngjarja është shënuar ditën e djeshme rreth orës 14:35 minuta në një lokal përgjatë autostradës Elbasan-ish-Metalurgjik. Si pasojë e plumbave janë plagosur 3 persona, por fatmirësisht të plagosurit ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Sakaq, uniformat blu kanë mbërritur në vendngjarje, dhe kanë krijuar një perimetër të gjerë sigurie përreth lokalit ku ndodhi konflikti,ndërkohë që po punohet për ndalimin e autorëve të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje. Ndërsa lokali ku ndodhi sherri është një ndër më të njohurit në qytetin e Elbasanit dhe nuk rezulton të ketë pasur probleme më parë. Ngjarja ndodhi kur dy vëllezërit, Franc e Hajdar Copa u konfliktuan me dy persona të tjerë, shtetait Julian e Klevis Gjini kushërinj me njëri-tjetrin. Shkak për konfliktin, sipas policisë dyshohet të jetë bërë një konflikt i vjetër mes të rinjve kur kanë qenë rezidentë në Angli. Klevis Gjini, dyshohet se mund të jetë përfshirë në trafik droge në Britani. Në lidhje me këtë rast materialet e mbledhura iu kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan për veprime të mëtejshme. Nga ana e grupit hetimor po punohet ende për sqarimin e rrethanave të kësaj ngjarje.

Ermal Vija

Më të lexuarat




Të tjera detaje të forta rreth ngjarjes që tronditi opinionin, grupi hetimor zbardh planin e fshehtë që kishte autori pasi vrau biznesmenin në Himarë dhe plagosi motrën e tij




“Mbylle gojën se do vritesh dhe ti!”, zbardhen detaje nga vrasja e biznesmenit në Himarë, ja çfarë i tha autori pastrueses dhe më pas u largua më këmbë nga vendngjarja




Përfshihet nga flakët makina në rrugën e Kavajës, Policia jep detaje




“Imuniteti thyhet dhe ka komplikacione të rënda”/ Mjeku Arjan Mezini tregon cilët janë ditët ‘problemاتي’ të një pacienti me Covid-19




Infektohet me Covid-19 gazetari i televizionit të njohur shqiptar, lajmëron publikisht: Një Zot e di sesa jam ruajtur, por...




Në kërkim ndërkombëtar për shfrytëzim prostitucioni, kush është 44 vjeçari me katër emra që ekstradohet nga Italia




Atentati që tronditi Himarën, flut fqiinj, tregon detaje për biznesmenin që u vra: Ishte njeri shumë...




“Shkolla mbyllet në 2 nëntor për 3 muaj”, email që ka mbërritur në adresat e shumë mësuesve bëri xhiron e rrjetit, reagon Ministria e Shëndetësisë dhe tregon si qëndron e vërteta




Thellohet aksidenti tragjik, vdes edhe shqiptari i katërt, kryediplomatja jep lajmin e hidhur



“Policë në Shqipëri gogol, në SHBA shpërndan maska”, publikon videon që po shpërndahet me shpejtësi: Pandemia një “lumë i dalë nga shtrati”




U tha se ishte zhdukur, familjarët u alarmuan, zbardhet çfarë i kishte ndodhur 40-vjeçarit



Foto/ Rrëmbëu armën dhe vrau në sy të motrës biznesmenin në Himarë. Ky është 53-vjeçari që e ekzekutoi me 5 plumba Niko Goron

Mesazhe Promocionale

Gossip



VIDEO/ Ankohet këngëtarja e njohur shqiptare dhe tregon momentet e 'padurueshme': Nuk rrija dot në makinë me Genc Prelvukaj, fliste vetëm për...

Tringa Kay, ka kujtuar në emisionin ‘Glamour Zone’ , disa momen...

Opinione



BARDHYL BEJKO

Balloja e maskave në të vërtetë si revolucion n...



BESI BEKTESHI

Limitet dhe vështirësitë e një aspiranti për kr...



YLLI MEÇE

Shpirtrat e “vdekur” të një kryehetuesi të pash...



Sot mbush 112 vjeç, por duket sa mosha e "njeri...

LEXO OPINIONE TE TJERA